



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 1286/1 prot.

Tiranë, më 18.05.2026

Lënda: Mendim mbi projektudhëzimin e përbashkët të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrit të Punëve të Brendshme në zbatim të ligjit për kontrollin e kufirit shtetëror

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “*Zyra e Komisionerit*”), ka administruar shkresën tuaj me nr. 2118 prot., datë 08.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1286 prot., datë 12.05.2026, me anë të të cilës dërgoni për mendim projektudhëzimin e përbashkët të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, të hartuar në zbatim të pikës 3, të nenit 32 të ligjit nr. 39/2025 “*Për kontrollin e kufirit shtetëror*”, si dhe relacionin shoqërues të tij.

Nga shqyrtimi i projektudhëzimit të përbashkët të dërguar, Zyra e Komisionerit vlerëson angazhimin tuaj në përcaktimin e rregullave mbi kategorinë e subjekteve të të dhënave personale që do të përpunohen, qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të tyre, anonimizimin, afatet e ruajtjes dhe asgjësimit, si përcaktimin e roleve gjatë aksesit sipas strukturave përkatëse.

Megjithatë, me qëllim që projektudhëzimi i përbashkët “*Për përcaktimin e rregullave për administrimin e të dhënave të grumbulluara në zbatim të ligjit për kontrollin e kufirit shtetëror*”, të jetë në të njëjtën linjë me legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së të dhënave personale, vlerësojmë nevojën e disa saktësimeve, të cilat i dërgojmë, si më poshtë vijon:

Në pikën 1 të projektudhëzimit, vërejmë se parashikohet në mënyrë të përgjithshme mbledhja e të dhënave personale për identifikimin e personave, në masën e nevojshme dhe në funksion të kontrollit kufitar.

Mbështetur në parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, vlerësojmë që, **në këtë pikë të projektudhëzimit**, të dhënat personale duhet të

identifikohen në mënyrë konkrete, duke specifikuar për secilën kategori të subjekteve, sa dhe cilat të dhëna personale do të përpunohen e që janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e strukturave përgjegjëse të Policisë së Shtetit. Përcaktimi i kategorive specifike të të dhënave personale duhet të realizohet në harmoni me parimin e përpunimit në përputhje me qëllimin dhe parimin e minimizimit të të dhënave, të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 6 të ligjit nr. 124/2024 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” (në vijim “*Ligji nr. 124/2024*”). Këto parime kërkojnë që të dhënat personale të mbledhen për qëllime specifike, të qarta dhe të ligjshme, si dhe të jenë të kufizuara vetëm në masën e nevojshme për arritjen e këtyre qëllimeve.

Në fjalinë e parë, të pikës 2 të projektudhëzimit, sugjerojmë riformulimin me përmbajtje: “*Roja Kufitare, në funksion të kontrollit kufitar, përpunon të dhëna personale në përputhje me parimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, vetëm në masën e nevojshme dhe proporcionale për realizimin e një kontrolli kufitar sa më efektiv*”.

Në fjalinë e parë, të pikës 13 të projektudhëzimit, sugjerojmë saktësimin, duke përcaktuar në mënyrë të qartë të dyja mënyrat e realizimit të proceseve përpunuese, si vijon: “*Të dhënat personale të përpunuara në mënyrë elektronike dhe manuale nga roja kufitare....*”.

Në vijim, ju sjellim në vëmendje se, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron dhe mbikëqyr respektimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë, përfshirë ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale nga strukturat e Policisë së Shtetit, në kuadër të kontrollit kufitar.

Referuar sa më sipër, edhe strukturat përgjegjëse të përcaktuara në këtë projektudhëzim të përbashkët për përpunimin e të dhënave personale, janë të detyruara të raportojnë tek Komisioneri, sipas kërkesës së tij, lidhur me çdo informacion të nevojshëm për verifikimin e përputhshmërisë së përpunimit të të dhënave personale me legjislacionin në fuqi.

Në këtë kuadër, sugjerojmë riformulimin e nenit **18 të projektudhëzimit**, me përmbajtje si vijon: “*Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron respektimin e rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim të përbashkët. Me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së përpunimit të të dhënave personale me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, çdo strukturë përgjegjëse që përpunon të dhëna personale sipas përcaktimeve në këtë udhëzim të përbashkët, është e detyruar të vendosë në dispozicion të Komisionerit të gjitha informacionet dhe regjistrimet e nevojshme, sa herë që ai i kërkon*”.

Në pikën 19 të projektudhëzimit parashikohet se subjektet e të dhënave gëzojnë të drejtën për informim mbi të dhënat personale të përpunuara, në zbatim të ligjit për kontrollin e kufirit shtetëror.

Me qëllim garantimin e të gjitha të drejtave ligjore të subjekteve të të dhënave, të parashikuara në Kapitullin III, të Pjesës III të Ligjit nr. 124/2024, sugjerojmë që, **pika 19 e projektudhëzimit**, të riformulohet me përmbajtje si vijon:

“Subjektet, të dhënat personale të të cilëve përpunohen nga roja kufitare në zbatim të ligjit nr. 39/2025 “Për kontrollin e kufirit shtetëror”, gëzojnë të drejtat për informim, akses, korrigjim, fshirje ose kufizim të përpunimit, si dhe të drejtën për rishikimin e përgjigjes, sipas Ligjit nr.124/2024”. Këto të drejta ushtrohen nëpërmjet strukturave përgjegjëse të Policisë së Shtetit, të përcaktuara me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”.

Për sa më sipër, me reflektimin e propozimeve të sipërpërmendura, Zyra e Komisionerit vlerëson projektudhëzimin e përbashkët në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfirmon dakordësinë për vijimin e procedurave për bashkëfirmosje.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi